



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 22 mars 2017, në mbledhjen e XXXIV (tridhjetekatër) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Bahri Selimi, Radisav Perović dhe Xhafer Ademi, Mefail Rama, Shaban Osmani, Xhevdet Beselica, Sabri Hamiti dhe Valmire Lahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare dhe Kuti Balazs, KFOR.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16 shkurt 2017

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Raporti i punës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2016

z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e paraqiti fjalën hyrëse, përkatësisht në detaje, pjesë pjesë, i sqaroi punën, aktivitetet dhe angazhimet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në vitin 2016.

z. Xhevdet Beselica, theksoi, e përgëzoi Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, përkatësisht z. Liman Zeqirin, shef i asaj Zyreje për përkushtimin dhe punët e suksesshme të realizuara në vitin 2016 si dhe përgatitjen e këtij raporti në mënyrë mjaftë gjithëpërfshirëse duke i konkretizuar në detaje çështjet konkrete sipas sferave përkatëse.

Kërkoj falje, do të dal jashtë temës të kësaj pike të rendit të ditës por dëshiroj të them, Partitë politike për Plan programet e tyre, model duhet t'i marrin dokumentet e kësaj Zyreje.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, bashkëpunimi në mes të Komitetit për Komunitete dhe Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është në nivel shumë të lartë dhe ne jemi në dijeni për punët dhe angazhimet e kësaj Zyreje, punë të cilat në mënyrë konkrete dëshmohet përmes këtij Raporti.

Pas votimit u konstatua se ky Raport u miratua njëzëri.

4. Raporti i Grupit punues për vizitë familjet e komuniteteve RAE në rrugën “ Xhafer Meta “ në Podujevë

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Xhafer Ademi, theksoi, kryesuesi në fjalën hyrëse tregoi se më 21 shkurt 2017, grupi në përbërje Shaban Ahmeti, Shaban Osmani, unë Xhafer Ademi dhe Liman Zeqiri kemi qenë në vizitë në këtë lagje, vizitë për të cilën e keni marrë Raportin me përshkrim të gjendjes. Gjatë vizitës jemi informuar drejtpërdrejt me shqetësimet e banorëve të asaj lagjeje.

Në raport e keni të shënuar se rasti më i rëndë është rasti i familjes së Bashkim Behlulit, të cilit i është djegur shtëpia, aktualisht duhet të ndërmerren veprimet për largimin e mbeturinave nga djegia e shtëpisë, për çka së bashku me të përmendurin kam qenë te Kryetari i Komunës, i cili na ka premtuar se do t'i angazhoj subjektet relevante për largimin e atyre mbeturinave.

Gjithashtu premtimet institucionale janë se i përmenduri do të ndihmohet edhe për riparimin e shtëpisë, në aspektin e ofrimit të materialit ndërtimor ndërsa punimet do t'i kryej komuniteti.

z. Liman Zeqiri, theksoi, kryesuesi z. Shaban Ahmeti, në fjalën hyrëse dhe Xhafer Ademi në diskutimin e tij, e përshkruan rastin e familjes 12 anëtarëshe të Bashkim Behlulit, andaj unë në këtë drejtim nuk do të shtoj asgjë por dëshiroj t'iu informoi se kemi ndërmarr të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës së mundshme për riparimin e shtëpisë së djegur.

Gjithashtu jemi të angazhuar për ofrimin e ndihmave nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale por edhe ndihmave tjera nga donatorët eventual.

Përndryshe për rastin për të cilin jemi duke debatuar është i informuar edhe Kryetari i Komunës.

Raporti u miratua njëzëri.

5. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50'.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01-060/04-30644/17

Podujevë,

22 mars 2017

Kryesuesi i Komitetit

Shaban Ahmeti